

**STATUTI
DHE AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

OPEN INV SHPK

Sot më datë 31/05/2022, në Tiranë ne selinë e shoqërisë së re me adresën e cituar ne Nenin 3 më poshtë Ortaku i Shoqërisë të identifikuar ne Nenin 1 më poshtë bie dakort të themelojë shoqërine me përgjegjësi të kufizuar ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas dispozitave statutore si më poshtë:

**PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortakët**

Shoqëria perbehet nga 1 ortak i vetem: **Klaus Veliu**, shtetas shqiptar, lindur në Lushnje, Shqipëri, me datë 07-07-1989, mbajtës i pasaportes Nr. BI3582830 me Nr. Personal I90707034L.

**Neni 2
Emri**

Emri i shoqërisë është: **OPEN INV** (më poshtë referuar si "shoqëria").
Emri i Tregtar është: **OPEN INV**

**Neni 3
Selia e shoqërisë**

- 3.1 Selia e shoqërisë është në adresen: Rruga "Sotir Kolea" Nr.12 Tirane
- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, përfaqësi në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit.

**Neni 4
Forma ligjore**

Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.



Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 6
Objekti i Shoqërisë

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë:

Investime në fushën e pasurive të paluajtshme, energjise të rinovueshme, bujqësi, si dhe çdo fushë tjetër, tregeti të mallrave industriale, bujqësore ushqimore etj, import-eksport, konsulence në fushën financiare dhe në fushën e investimeve etj. si dhe çdo aktivitet tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi si dhe praktikatat e shëndosha kombëtare e ndërkombëtare.

6.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve

PJESA II
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË DHE KUOTAT


Neni 7
Kapitali i shoqërisë

7.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000 (një mijë) Lekë. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në një (1) kuotë me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

PJESA III.
STRUKTURA DREJTUESE
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 8
Përgjegjësia e kufizuar

Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.



Neni 9
Të drejtat e lidhura me cdo kuotë

Cdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotave së tij dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të shoqërisë.

Neni 10
E drejta e pjesëmarrjes në mbledhjet e Asamblesë

- 10.1 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e shoqërisë në mbledhjet e shoqërisë.
- 10.2 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e shoqërisë personalisht ose me prokurë, të informohet mbi çështjet e Shoqërisë si dhe të inspektojë dhe kontrollojë librat dhe regjistrat e Shoqërisë.


Neni 11
Detyrimet e ortakëve

Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

PJESA IV
ASAMBLEJA ORTAKEVE

Neni 12
Të drejtat e asamblesë së ortakëve

- 12.1 Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e ortakëve përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm asambleja e ortakëve ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime të Statutit;
 - (b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - (c) pranimin e ortakëve të rinj;



- (d) vendimin mbi përjashtimin e një ortaku në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
- (e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
- (f) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të shoqërisë;
- (g) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit;
- (h) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërive si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (i) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (j) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme;
- (k) të vendosë për investimet;
- (l) të marrë hua ose kredi në cdo lloj shume;
- (m) të japë hua ose kredi në cdo lloj shume;
- (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (o) të lëshojë/revokojë prokura ose autorizime për të vepruar në emër të shoqërisë jashte tagreve administrimit të zakonshem.
- (p) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi për marrjen e shërbimeve ndaj paleve të treta të cilat nuk përbejnë shërbime utilitare;
- (r) caktimin e auditorëve;
- (s) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
- (t) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të shoqërisë;
- (u) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (v) miratimin e çdo çështjeje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së ortakëve në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

12.4 Në çdo rast asambleja e ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë mbi çdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

Neni 13

Vendimet e asamblesë së ortakëve

13.1 Vendimet e renditura në Nenin 12.3 mund të merren me shumice të thjeshte përveç rasteve kur ligji parashikon dicka tjetër.

Neni 14

Thirrja e asamblesë së ortakëve

- 14.1 Asambleja e ortakëve do të mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e asamblesë së ortakëve thirret të paktën një herë në vit.
- 14.2 Gjithashtu, administratorët kanë detyrimin të thërrasin asamblenë e ortakëve nëse dicka e tillë kërkohet nga ortakët që së bashku përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë apo nëse dicka e tillë kërkohet nga vetë administratorët.
- 14.3 Asambleja e ortakëve do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, telexi, faksi apo postë elektronike jo më pak se 15 ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Ftesa e shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë.
- 14.4 Ftesa për takimin e asamblesë së ortakëve do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse asambleja e ortakëve nuk thërritet nga administratori brenda kohës së caktuar, në 15 (pesëmbëdhjetë) ditët në vazhdim secili prej ortakëve mund të thërrasë këtë asamble.
- 14.6 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.7 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër.

Neni 15

Vendimet e marra në asamblenë e ortakëve/procesverbali

- 15.1 Vendimet në asamblenë e ortakëve mund të merren me shumice të thjeshtë vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kuotave të kapitalit dhe/ose përfaqësuesve të tyre.
- 15.2 Prokura duhet të jetë e noterizuar dhe të paraqitet në mbledhjen e ortakëve.
- 15.3 Çdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e ortakëve, të cilët do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e ortakëve thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14. Axhenda e mbledhjes së dytë do të mbesë e pandryshuar.


Mbledhja e dytë e ortakëve ka të drejtë të marrë vendime mbi çështjet e caktuara në rendin e ditës pavarësisht nga kuorumi (numri i kuotave të përfaqësuara).

- 15.5 Vendimet e mbledhjes së ortakëve mund të merren dhe me anë të korrespondencës së shkruar, telekonferencës, video konferencës dhe të tjera mënyra të ngjashme – nëse të gjithë ortakët kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak dhe identiteti i ortakëve mund të përcaktohet pa dyshim.
- 15.6 Për cdo mbledhje të ortakëve do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin ortak.
- 15.7 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande, dorazi ose me poste elektronike jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve.

PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 16 Administrimi i shoqërisë

- 16.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administrator i shoqërisë është **Klaus Veliu**, shtetas shqiptar, lindur në Lushnje, Shqipëri, me datë 07-07-1989, mbajtës i pasaportes Nr. BI3582830 me Nr. Personal I90707034L, i cili emërohet për një periudhë 5 vjeçare.
- 16.2 Administratori mund të autorizojnë palë të treta që ta përfaqësojnë në transaksione të vecanta.
- 16.3 Administratori do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ai është të autorizuar të përfaqësojnë shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të ne kuadrin e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.
- 16.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, Akti i themelimit, vendimet e ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 16.5 Dukë marrë parasysh kufizimet e Nenit 12 më sipër, administratori ka të drejtat e mëposhtme:
 - (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - (b) çeljen e llogarive bankare dhe të drejten për të vepruar, pranë çdo banke të nivelit të dytë;



- (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta të cilat nuk bien në kompetencat e Asamblese, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, pagimin e detyrimeve të shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- (f) propozimin për punësimin dhe shkarkimin e stafit të shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit në përputhje me politikat e aprovuara nga Asambleja;
- (g) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
- (h) administratorët kanë të drejtë marrin çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (i) mbledhjen e shpenzimeve të shoqërisë;
- (j) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (k) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- (l) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (m) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (n) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të shoqërisë;
- (o) Regjistrimin fillestar dhe operimin në vazhdim të shoqërisë me të drejta delegimi pranë personave të treta, pranë QKB apo Drejtorise Tatimore


PJESA VI

VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 17

Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

- 17.1 Viti financiar i shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.



- 17.2 Në fund të cdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të asetëve të shoqërisë dhe strukturës së tyre;
 - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të shoqërisë;
 - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 17.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm, nëse ka, për miratim.

Neni 18
Fitimi i shoqërisë

- 18.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahe në raport me kuotat e zotëruara.
- 18.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore.

PJESA VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI


Neni 19
Prishja dhe likuidimi

- 19.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - (b) riorganizimi i shoqërisë;
 - (c) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 19.2 Likuidimi i shoqërisë dhe shpërndarja e asetëve të shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA VIII
TE PERGJITHSHME

Neni 20
Të përgjithshme

- 20.1 Në rast të mosmarrëveshjeve të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata e juridiksionit përkatës.



- 20.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar. Për të gjitha çështjet të cila nuk parashikohen në këtë statut do i bëhet referencë Ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 20.3 Ky statut dhe Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet në 3(tre) kopje origjinale.

Në Tiranë, më datë 31.05.2022

Ortaku i vetëm

Klaus Veliu 